



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË

**SHUKALB**
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Korrik 2022

SHUKALB pret dhe bashkëorganizon me sukses Forumin e Ujit të Danubit 2022



Ne në SHUKALB jemi të emocionuar që kemi qenë mikpritës dhe bashkëorganizator i Forumit të Ujit të Danubit 2022, me temë “Energjizimi i Sektorit të Ujit në Rajonin e Danubit”, mbajtur në Tiranë, në datat 28-29 qershor. Udhëtimi që filluam gati 10 vjet më parë nën Programin e Ujit të Danubit na ka çuar në një nivel tjetër zhvillimi si shoqatë, duke na ofruar programe të zhvillimit të kapaciteteve për shoqëritë UK tona anëtare nën D-LeaP, mundësi që ne si shoqatë të bëhemi më të fortë, dhe tani duke qenë në gjendje të presim një nga eventet më të rëndësishëm të Programit të Danubit, Forumin e Ujit të Danubit. [lexo më shumë](#)

Konferenca “Lidhja e Benchmarking dhe Menaxhimit të Aseteve – Mjetet kryesore për rregullatorët dhe vendimmarrësit”

Trajnimet dhe programet e ardhshme të zhvillimit të kapaciteteve

[Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimin të Ujërave të Ndotur për Menaxherët dhe Inxhinierët Shtator-Nëntor 2022](#)

[Riparimi dhe Rehabilitimi i Sistemit të Kanalizimeve 28-29 Shtator 2022, Tiranë](#)

Konferencat e Ardhshme Ndërkombëtare

[Kongresi dhe Ekspozita Botërore e Ujit e IWA, Shtator 2022](#)

Kopenhagen, Danimarkë
11-15 Shtator 2022

[Konferenca dhe ekspozita teknike vjetore e 95-të](#)



New Orleans, Louisiana,
SHBA
8-12 Tetor 2022

Samiti Dixhital i Ujit

Bilbao, Spanjë
29 Nëntor – 2 Dhjetor 2022

Forumi i Ujit të Danubit 2022 u pasua nga Konferenca “Lidhja e Benchmarking dhe Menaxhimit të Aseteve – Mjetet kryesore për rregullatorët dhe vendimmarrësit”, i cili u mbajt më 30 qershor 2022 në Tiranë.

Konferenca mbledhi më shumë se 130 pjesëmarrës, që përfaqësonin institucionet kombëtare (ministritë, rregullatorë); shoqatat kombëtare të ujit dhe bashkive, qeverisja vendore dhe shoqëritë UK nga rajoni i Danubit; përfaqësues nga shoqatat rajonale të ujit (IAWD), të bashkive (NALAS) dhe rregullatorëve (WAREG); përfaqësues nga BE, UNECE, GIZ, SDC, Banka Botërore dhe donatorë të tjerë dypalësh dhe IFN; Profesionistë të rinj të ujit; academia; kompani private; OJQ-të dhe të tjera. [lexo më shumë](#)

Bashkohuni me Ne!



Lajme nga Sektori

Krijohen 3 Shoqëritë e para Rajonale Ujësjaellës Kanalizime në kuadër të Reformës së re në Sektor



Na tregoni se cfarë mendoni!



Rreth SHUKALB

Më 28 qershor 2022, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përfundoi krijimin e tre Shoqërive të para Rajonale Ujësjaellës Kanalizime, në përputhje me Vendimin më të fundit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 302, datë 11.5.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe

Shoqata Ujësjaellës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale,

të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”. [lexo më shumë](#)

Çfarë ka të re në SHUKALB!

SHUKALB finalizon trajnimet në Shoqëritë UK në kuadër të programit D-LeaP “Plani i Sigurisë së Ujit dhe Menaxhimi i Krizave”



Gjatë datave 8-15 Qershor 2022, SHUKALB zhvilloi trajnimin e 3-të dhe të 4-të për Shoqëritë UK Durrës, Shkodër dhe Fier, në kuadër të programit D-LeaP “Plani i Sigurisë së Ujit dhe Menaxhimi i Krizave”. Aktiviteti po mbështetet nga IAWD dhe RCDN.

Ekipi i SHUKALB përbëhet nga trajnerja kryesore Migena Kukli, bashkëtrajner Elton Hasanaj, Drejtoresha Ekzekutive, Elisabeta Poçi dhe Francesca Troka, Koordinatore e Programit. [lexo më shumë](#)

SHUKALB organizon me sukses Trajnimin e Avancuar të Fazës Platin në kuadër të Projektit “Shërbime Këshillimore për Menaxhimin e Aseteve për Kompanitë e Ujit në Evropën Juglindore”

jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri.



Gjatë datave 1-3 qershor 2022, SHUKALB në bashkëpunim me Shoqatën e Ujësjetësve dhe Kanalizimit të Kosovës (SHUKOS) organizuan me sukses trajnimin 3-ditor të Fazës Platin lidhur me temën e Auditimit të Ujit, për Shoqëritë Ujësjetëse Kanalizime (UK) në Shqipëri dhe Kompanitë Rajonale të Ujësjetësit në Kosovë. Trajnimi u organizua në Tiranë në kuadër të Projektit " Shërbime Këshillimore për Menaxhimin e Aseteve për Kompanitë e Ujit në Evropën Juglindore". [lexo më shumë](#)

Trajnime dhe programe të zhvillimit të kapaciteteve

Thirrje për pjesëmarrje në programin e zhvillimit të kapaciteteve me temë "Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët"



SHUKALB ka kënaqësinë t'ju ftojë të merrni pjesë në Programin e Zhvillimit të Kapaciteteve për Kanalizimet dhe Ujërat e Ndotura me titull "Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët", i cili do të pilotohet për herë të parë në kuadër të Projektit "Rrjeti Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (RCDN)".

Programi konsiston në 3 trajnime mbi temat e aspekteve rregullatore, financuese, teknologjike dhe të menaxhimit të një projekti infrastrukturor, si dhe një shkëmbim mes kolegësh, i cili do të organizohet gjatë muajve shtator – nëntor 2022. [lexo më shumë](#)

Të tjera

Projekti RCDN organizon në Tiranë Trajnimin specifik të Trajnerëve për Programin e Ujërave të Ndotura me temë “Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët”



Në datat 7-10 Qershor 2022, Rrjeti Rajonal për Zhvillimin e Kapaciteteve për Shërbimet e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (RCDN), organizoi në Tiranë Trajnimin specifik 3.5 ditor të Trajnerëve (ToT) për Programin e zhvillimit të kapaciteteve të Ujërave të Ndotura (UN) me temë “Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët”.

Objekti i përgjithshëm i trajnimit ishte rritja e kompetencës teknike dhe metodologjike të trajnerëve për të qenë në gjendje të ofrojnë Programin e RCDN të UN “Hyrje në Sistemet e Kanalizimeve dhe Trajtimit të Ujërave të Ndotura për Menaxherët dhe Inxhinierët”. [lexo më shumë](#)

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore harton Ligjin për Burimet Ujore dhe Ligjin për Strategjinë Detare të Republikës së Shqipërisë

Projektligji për Burimet Ujore

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e burimeve ujore të Republikës së Shqipërisë, duke siguruar ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të tyre, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social ekonomik të vendit.

Ju lutemi klikoni në linkun mëposhtë për të parë dokumentin:

http://www.ambu.gov.al/wp-content/uploads/2022/05/Draft-Projektigj-Per-Burimet-Ujore-EUSIWM_23.05.2022.pdf

Projektligji për Strategjinë Detare të Republikës së Shqipërisë

Qëllimi i këtij ligji është krijimi i kuadrit ligjor për arritjen dhe mirëmbajtjen e një statusi të mirë mjedisor të ujërave detare të Detit Mesdhe, të cilat janë nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë.

Ju lutemi klikoni në linkun mëposhtë për të parë dokumentin:

<http://www.ambu.gov.al/wp-content/uploads/2022/06/Draft-projektligj-per-Strategjine-detare.pdf>

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjiellës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", 39/1, k5, 3, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, Web: www.shukalb.al

Çregjistrohu